



104/19

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË VLORË

Nr. 117 Prot.(Xh.S) ✓

Vlorë, më 22/02/2019

Lënda: Dërgohet urdhëri i ekzekutimit të vendimit penal.

ZYRËS VENDORE TË SHËRBIMIT TË PROVËS

V L O R Ë

MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË

Drejtorisë së Përgjithshme të Pronës Publike

T I R A N Ë

ZYRËS PËRMBARIMORE

V L O R Ë

PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË

V L O R Ë

GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË

V L O R Ë

DHOMËS SË AVOKATISË

Av. Blerim Hallulli, Edmond Dëma dhe Halit Demaj

V L O R Ë

Shtetasit: Petro Beja

Adresa: Gjilekë, Himarë

V L O R Ë

Shtetasit: Theodhori Beja

Adresa: Lagjia "28 Nëntori", Rruga "Mulla Xhaferi", Pallati nr.1084, Hyrja nr.1, Kati nr.4

V L O R Ë

Shtetasit: Thoma Beja

Adresa: Lagjia "Pavarësia", Rruga "Jani Kosta", Pallati pranë piceri "Boklyn", Hyrja

nr.1, Kati nr.8

V L O R Ë

Bashkëlidhur me këtë shkresë po ju dërgojmë urdhërin e prokurorit nr.104, datë 21/02/2019, për ekzekutimin e vendimit penal të formës së prerë nr.564(61-2017-4424), datë 04/10/2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, si dhe aktet bashkëngjitur.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin.

ME URDHËR DHE DELEGIM  
ZËVENDËS DREJTUESI I PROKURORISË  
Albert KULIÇI

DREJTUESI I PROKURORISË

Ardian YLLI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË VLORË

**URDHËR**

Nr.104, datë 21/02/2019

Për ekzekutimin e vendimit nr.564(61-2017-4424), datë 04/10/2017  
të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë

Në Vlorë, viti 2019, muaji Shkurt, datë 21.

Unë Xhemal Saliaj, Prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, pasi u njoha me përmbajtjen e vendimin penal nr.564(61-2017-4424), datë 04/10/2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, dërguar me shkresën nr.1446, datë 18/02/2019, për të dënuarin:


1. Petro Beja, i biri i Thomait dhe i Fotinasë, i datëlindjes 01/03/1937, lindur në Dhërmë, Vlorë dhe banues në Vlorë, i hetur dhe gjykuar pa masë sigurimi, mbrojtur nga av.Blerim Hallulli.
2. Theodhori Beja, i biri i Thomait dhe i Fotinasë, i datëlindjes 01/07/1941, lindur në Dhërmë, Vlorë dhe banues në Vlorë, Lagjia "28 Nëntori", Rruga "Mulla Xhaferi". Pallati nr.1084, Hyrja nr.1, Kati nr.4, i hetur dhe gjykuar pa masë sigurimi, mbrojtur nga av.Halit Demaj,
3. Thoma Beja, i biri i Petros dhe i Zaharullës, i datëlindjes 18/08/1963, banues në Vlorë, Lagjia "Pavarësia", Rruga "Jani Kosta", Pallati pranë piceri "Boklyn", nr.1084. Hyrja nr.1, Kati nr.8, i hetur dhe gjykuar pa masë sigurimi, mbrojtur nga av.Edmond Dëma,

**KONSTATOVA:**

Se me vendimin penal nr.564(61-2017-4424), datë 04/10/2017, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur:

1. Deklarimin fajtor të të pandehurit Petro Beja, për kryejën e veprës penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale", parashikuar nga Neni 287, gërma "a", "b" dhe "c" i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 7 (shtatë) vjet burgim.

2. Në zbatim të Nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, ulet 1/3 e dënimit.
3. Në zbatim të Nenit 59 të Kodit Penal, urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim për të pandehurin dhe vënia e tij në provë për një afat kohor 5 (pesë) vjet.
4. Urdhërohet i pandehuri Petro Beja të mbajë kontakte me shërbimin e provës dhe të njoftojë këtë shërbim për ndryshimin e vendbanimit dhe lëvizjet e tij brenda vendit.
5. Deklarimin fajtor të të pandehurit Theodhori Beja, për kryejën e veprës penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale", parashikuar nga Neni 287, gërma "a", "b" dhe "c" i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 7 (shtatë) vjet burgim.
6. Në zbatim të Nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, ulet 1/3 e dënimit.
7. Në zbatim të Nenit 59 të Kodit Penal, urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim për të pandehurin dhe vënia e tij në provë për një afat kohor 5 (pesë) vjet.
8. Urdhërohet i pandehuri Theodhori Beja të mbajë kontakte me shërbimin e provës dhe të njoftojë këtë shërbim për ndryshimin e vendbanimit dhe lëvizjet e tij brenda vendit.
9. Deklarimin fajtor të të pandehurit Thoma Beja, për kryejën e veprës penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale", parashikuar nga Neni 287, gërma "a", "b" dhe "c" i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 5 (pesë) vjet burgim.
10. Në zbatim të Nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, ulet 1/3 e dënimit.
11. Në zbatim të Nenit 59 të Kodit Penal, urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim për të pandehurin dhe vënia e tij në provë për një afat kohor 5 (pesë) vjet.
12. Urdhërohet i pandehuri Thoma Beja të mbajë kontakte me shërbimin e provës dhe të njoftojë këtë shërbim për ndryshimin e vendbanimit dhe lëvizjet e tij brenda vendit.
13. Deklarimin të fallsifikuar të dokumentacionit të sekuestruar si provë materiale me procesverbalet e datës 12/07/2016, datës 15/09/2016 dhe datës 19/09/2016 pranë Zyrës së Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë dhe më pas të asgjësohet ky dokumentacion.
14. Pasuria e paluajtshme e vendosur nën masën e sigurimit pasuror "Sekuestro Preventive", me vendimin nr.249, datë 15/07/2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë e llojit "Kullotë", "Pyll", me sipërfaqe totale prej 54.6 ha e ndodhur në fshatin "Gjilekë", Dhërmi, rregjistruar pranë Zyrës së Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë me numrat hipotekor 440, 441, 442 dhe 443, datë 20/12/2006 dhe nr.207, datë 31/07/2008, që kanë patur si titull pronësie vendimet nr.133, nr.134, nr.135, nr.136 datë 20/05/2006 dhe nr.175, datë 21/06/2006 të Komisionit Vendor të Kthimit dhe Kompësimit të pronave, Qarku Vlorë dhe vendimin nr.1333, datë 19/05/2008 të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, të konfiskohen dhe të kalojnë në favor të shtetit.
15. Shpenzimet procedurale të kryera në fazën e hetimeve paraprake dhe në fazën e gjyqimit, në shumën 19 000 (nëntëmbëdhjetë mijë) lekë, janë në ngarkim të të pandehurit



Handwritten signature and official stamp of the court.


Vendimi penal nr.564(61-2017-4424), datë 04/10/2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë ka marrë formë me vendimin nr.614, datë 22/11/2018 të Gjykatës së Apelit Vlorë, e cila ka vendosur:

1. Prishjen e vendimit nr.564(61-2017-4424), datë 04/10/2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe pushimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurit Thoma Beja
2. Lënien në fuqi të vendimit të mësipërm për pjesën tjetër.
3. Shpenzimet procedurale për të pandehurin Thoma Beja i ngarkohen solidarisht dy të pandehurve Petro dhe Theodhori Beja

Për sa më sipër, bazuar në Nenin 462, Nenin 464, Nenin 465 dhe Nenin 486, paragrafi i parë i Kodit të Procedurës Penale, si dhe Nenin 12, Nenin 17, Nenin 22 dhe Nenin 23 të Ligjit nr.8331, datë 21/04/1998 "Për ekzekutimin e vendimeve penale",

### URDHËROJ:

1. Ekzekutimin e vendimit penal nr.564(61-2017-4424), datë 04/10/2017nr.155, datë 29/03/2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me qëllim plotësimin e kushteve dhe përmbushjen e detyrimeve nga të dënuarit Petro Beja dhe Theodhori Beja, disponimin mbi provat materiale, si dhe pagimin e shpenzimeve procedurale.
2. Për ekzekutimin e këtij urdhëri, lidhur me plotësimin e kushteve dhe përmbushjen e detyrimeve të vëna ndaj të dënuarëve Petro Beja dhe Theodhori Beja për të mbajtur kontaktet me shërbimin e provës për një periudhë kohe 5 (pesë) vjet, si dhe për të njoftuar këtë institucion për ndryshimin e vendbanimit dhe lëvizjet e tij brenda vendit, ngarkohet Zyra Vendore e Shërbimit të Provës Vlorë.
3. Për ekzekutimin e këtij urdhëri, lidhur me deklarimin e fallsifikuar dhe asgjësimin e provave materiale, **Konkretisht:** Provat materiale të sekuestruara me procesverbalet e datës 12/07/2016, datës 15/09/2016 dhe datës 19/09/2016 pranë Zyrës së Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë, ngarkohet policia gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë.
4. Për ekzekutimin e këtij urdhëri, lidhur me konfiskimin dhe të kalimin në favor të shtetit të pasurisë së paluajtshme, **Konkretisht:** Pasuria e paluajtshme e vendosur nën masën e sigurimit pasuror "Sekuestro Preventive", me vendimin nr.249, datë 15/07/2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë e llojit "Kullotë", "Pyll", me sipërfaqe totale prej 54.6 ha e ndodhur në fshatin "Gjilekë". Dhërmi, rregjistruar pranë Zyrës së Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë me numrat hipotekor 440, 441, 442 dhe 443, datë 20/12/2006 dhe nr.207, datë 31/07/2008, që kanë patur si titull pronësie vendimet nr.133, nr.134, nr.135, nr.136 datë 20/05/2006 dhe nr.175, datë 21/06/2006 të Komisionit Vendor të Kthimit dhe Kompesimit të pronave, Qarku Vlorë dhe vendimin nr.1333, datë 19/05/2008 të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, ngarkohet Zyra Përmbarimore Vlorë



3

5. Për ekzekutimin e këtij urdhëri, lidhur me pagimin e shpenzimeve procedurale solidarisht në shumën 19 000 (nëntëmbëdhjetë mijë) lekë , nga të dënuarit Petro Beja dhe Theodhori Beja, ngarkohet Zyra Përmbarimore Vlorë.
6. Urdhëri t'i njoftohet të dënuarit, mbrojtësit të tij, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si dhe Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë.
7. Për zbatimin e urdhërit të njoftohet Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë.

**PROKURORI**  
**Xhemal SALIAJ**

